



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:273693  
Datë: 08.08.2024  
Numri i dokumentit: 06031119

**K.DH.Shk II.nr.760/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Shkel e Shko“ Sh.p.k, me NRB:70483288, me seli në Prishtinë, Lagjia Dardania SU 1/5 H1, kundër debitorit “Tehno Burimi” D.D. SH.A., me NUI:810548307, me seli në Shupkove, Kullat e Malokve, Mitrovicë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1410/22 të datës 17.01.2024, me datë **07.08.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Shkel e Shko“ Sh.p.k, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1410/22 të datës 17.01.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1410/22 të datës 17.01.2024, në dispozitivin e aktvendimit e ka pranuar prapësimin e debitorit N “TehnoBurimi” D.D. SH.A., me NUI:810548307 duke anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.461/21 të datës 02.11.2021, të Përmbartuesit Privat Rezarta Metaj, dhe është përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, (me pretendime sikur në ankesë), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i

Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1410/22 të datës 17.01.2024, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Ankesa e kreditorit i është dorëzuar debitorit për përgjigje, mirëpo i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

**- Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N“Shkel e Shko“ Sh.p.k, ka paraqitur propozimin për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm - faturës me numër 21-SHV05-001-686 të datës 16.06.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që në emër të borxhit sipas faturës së lartcekur, t'ia paguaj shumën prej 2,115.33 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data e kalimit të afatit të pagesës e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar në tërësi propozimin për përmbartim, ndër të tjerash ka theksuar se obligimi nuk është siç është në lëndë sepse janë të faturuara edhe pajisje që sipas marrëveshjes janë vetëm në shfrytëzim, ka kërkuar që të korrigjohet fatura se për këtë arsye nuk është nënshkruar dhe pranuar fatura siç mund të verifikohet në shkresat e lëndës, dhe kjo është arsyeja pse nuk është paguar. Andaj i propozon gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, të anulohet Urdhri Përmbartimor, dhe të prishen veprimet e ndërmarra ngase obligimi i kërkuar nuk është real.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar pretendimet e debitorit, ndër të tjerash ka theksuar se debitori i kemi ofruar mundësi të shlyerjes së detyrimit dhe se nuk qëndron pretendimi i debitorit se janë faturuara edhe pajisje që sipas marrëveshjes janë vetëm në shfrytëzim dhe se i njëjti nuk merr as mundin që të tregoj se cila është ajo pajisje. Ka shtuar se urdhri përmbartimor është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm i cili përmban të gjitha elementet e nevojshme të parapara me LPP, dhe se faturat janë pranuar nga debitori pasi vet e pohon faktin se “faturën nuk e ka nënshkruar pa e korrigjuar”. Duke u bazuar në të lartcekurat i ka propozuar gjykatës, që të refuzohet si i pa themeltë prapësimi i debitorit, të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1410/22 të datës 17.01.2024, ku në dispozitivin e aktvendimit e ka pranuar prapësimin e debitorit N “TehnoBurimi” D.D. SH.A., me NUI:810548307 duke

anuluar urdhrin përbarimor P.nr.461/21 të datës 02.11.2021, të Përmbauesit Privat Rezarta Metaj, dhe është përfunduar në tërësi përbarimi në këtë çështje përbarimore.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në bazë të cilës është lejuar propozimi për përbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin apo vulën e pranuesit – debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njëjta është pranuar nga debitori në ndonjë mënyrë tjetër. Andaj, duke qenë se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën, si e tillë e njëjta nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbaueshmërisë.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përbarimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshme për përbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*.

Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkalles e dytë bazuar ne Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili ne nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh qe *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, konsideron se fatura nr. 21-SHV05-001-686 të datës 16.06.2021, dokument ne sajë te cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk ka prova se është pranuar nga debitori, njëjta nuk është e vulosur e as nënshkruar nga debitori , andaj, në këtë mënyrë fatura nuk mund konsiderohet si dokument i besueshëm.

Gjykata vlerësoi pretendimet e kreditorit në ankesë, por te njëjtat mbesin te pabazuara pasi nuk ka arrit ti argumentoj me prova juridikisht te vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si te tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet

ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e shkallës së dytë**  
**K.DH.Shk II.nr.760/24 , me datë 07.08.2024**

**Gjyqtari,**  
**Faton Bajrami d.v.**